

VENDIM
Nr. 134, datë 21.5.2026

**MBI REFUZIMIN E KËRKESËS PËR PEZULLIMIN E LICENCËS PËR
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË
SHOQËRISË “VOKOPOLA ENERGJI” SHPK, ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s
NR. 161, DATË 17.6.2022**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.5.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 455/12 prot., datë 20.5.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës dhe Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve “Mbi kërkesën për pezullimin e licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë ‘Vokopola Energji’ sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 161, datë 17.6.2022”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 161, datë 17.6.2022, ka licencuar shoqërinë “Vokopola Energji” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Vokopola 1”, me kapacitet të instaluar 274 kw, “Vokopola 2”, me kapacitet të instaluar 3104 kw, dhe “Vokopola 3”, me kapacitet të instaluar 2297 kw, me kapacitet total të instaluar 5675 kw, për një afat 25 vjet e 8 muaj.

- Me shkresën nr. 3/2-21-25 prot., datë 30.1.2026, protokolluar në ERE me nr. 455 prot., datë 2.2.2026, Z.A.V. (përfaqësuar nga studio ligjore “B&K Legal & Tax Consulting” sh.p.k.), ka ngritur pretendimin për cenim të pronës private nga shoqëria “Vokopola Energji” sh.p.k. dhe ka kërkuar pezullimin e licencës së kësaj shoqërie, si dhe marrjen e masave në zbatim të nenit 113 të Kodit të Procedurave Administrative, në lidhje me plotësimin e kushteve të licencës gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së saj.

- Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të depozituar në kuadër të procedurës së licencimit, është vlerësuar mbajtja e një seancë dëgjimore. Për këtë seancë është njoftuar kërkuesi me shkresën e ERE-s nr. 455/2 prot., datë 18.2.2026. Seanca është zhvilluar në ERE në datën 25.2.2026.

- Në këtë seancë, përfaqësuesve të kërkuesit i është sqaruar, se:

- Shoqëria “Vokopola Energji” sh.p.k. ka fituar të drejtën për ndërtimin, operimin dhe transferimin e HEC-eve “Vokopola 1, 2 & 3” nëpërmjet kontratës koncesionare të lidhur fillimisht me bashkimin e përkohshëm të shoqërive “UFO” sh.p.k. dhe “Geri 01” sh.p.k., të drejta që më pas i janë transferuar shoqërisë koncesionare;

- Për aplikimin për licencim është kryer njoftimi publik në median e shkruar dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s dhe nuk ka pasur asnjë koment apo kundërshtim gjatë afatit ligjor. (Nga pala kërkuese u deklarua se kishte dijeni për ndërtimin e HEC-it, por jo për shtrirjen konkrete të pronave të prekura);

- Nga dokumentacioni i administruar rezulton se projekti shtrihet mbi prona shtetërore të disponuara me kontrata qiraje me bashkitë Memaliaj, Skrapar dhe Poliçan. Kushti fillestar për depozitimin e kontratave të rinovuara është hequr me vendimin nr. 230, datë 30.9.2025, pas ndryshimeve rregullatore të miratuara me vendimin nr. 220, datë 1.9.2022, duke u vlerësuar se e

drejta e përdorimit të territorit nuk përbën më kusht licence në kuptimin rregullator të mbikëqyrur nga ERE;

- Pretendimet për lejen e ndërtimit nuk lidhen me procedurën e licencimit për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, pasi kjo licencë jepet për operimin e veprimtarisë dhe jo për ndërtimin e impiantit;

- Në kontratën e nënshkruar me Autoritetin Kontraktor janë parashikuar, gjithashtu, të drejtat në lidhje me përdorimin, kalimin apo gëzimin e sheshit ku do të bëhet ndërtimi, si dhe procedurat për testimin dhe kolaudimin e veprës.

- Pas këtyre sqarimeve, pala kërkuese deklaroi se i qëndron kërkesës për pezullimin e licencës deri në sqarimin e situatës nga autoritetet kompetente.

- Në vijim, me shkresën nr. 455/6 prot., datë 8.4.2026, ERE i përcolli kërkuessit një përmbledhje të diskutimeve të zhvilluara në seancë dhe kërkoi dokumentimin e pretendimeve, si dhe sqarime mbi mënyrën sesi cenimi i pretenduar i pronës afekton lejet dhe miratimet e tjera të projektit.

- Me shkresën nr. 455/8 prot., datë 17.4.2026, kërkuessi ka pretenduar se gjatë licencimit ERE është mbështetur vetëm në vetëdeklarimet e shoqërisë dhe nuk ka kryer verifikime mbi të drejtën e përdorimit të pronave ku shtrihet projekti.

Në lidhje me këtë pretendim, ERE sqaron se procedura e licencimit është zhvilluar në përputhje me kuadrin ligjor dhe dokumentacionin e depozituar nga subjekti aplikues, duke përfshirë kontratat e qirasë të lidhura me bashkitë Memaliaj, Skrapar dhe Poliçan. Për këtë arsye, pretendimi se ERE është mbështetur vetëm në vetëdeklarime nuk qëndron. Gjithashtu, dokumentacioni i dosjes së aplikimit i është vënë në dispozicion kërkuessit.

- Po ashtu, kërkuessi ka depozituar një akt ekspertimi privat, sipas të cilit HEC “Vokopola” prek prona private, ndërsa me shkresën nr. 455/10 prot., datë 22.4.2026, vetë kërkuessi ka deklaruar se prona në bashkëpronësi të tij preket nga HEC “Vokopola 3”.

Nga shqyrtimi i aktit të ekspertimit është konstatuar se të dhënat janë siguruar nga vetë kërkuessi dhe nuk rezulton të jetë kryer verifikim konkret në terren dhe për sa kërkuar nga ERE, nuk është dokumentuar nga kërkuessi se cenimi i pretenduar i pronës ka sjellë ndryshim apo shfuqizim të kontratës koncesionare, lejeve ujore, VNM-së apo miratimeve të tjera mbi bazën e të cilave është licencuar shoqëria.

- Me shkresën nr. 455/7 prot., datë 8.4.2026, ERE i është drejtuar shoqërisë “Vokopola Energji” sh.p.k., duke kërkuar qëndrimin dhe dokumentacionin mbështetës lidhur me kërkesën për pezullim të aktivitetit.

- Në përgjigje, me shkresën protokolluar në ERE me nr. 455/9 prot., datë 20.4.2026, shoqëria deklaroi se operon në përputhje me kuadrin ligjor dhe kontratën koncesionare BOT, duke disponuar të gjitha lejet dhe autorizimet përkatëse, përfshirë lejet mjedisore dhe ato për përdorimin e burimeve ujore. Shoqëria pretendoi, gjithashtu, se çështja përbën një mosmarrëveshje civile pronësie jashtë kompetencës së ERE-s.

- Për gjithë sa më sipër parashtruar, në referencë të sa pretenduar nga kërkuessi dhe sa argumentuar nga shoqëria, vlerësojmë të sqarojmë se ERE nuk është organi kompetent për të përcaktuar vendndodhjen konkrete të objektit energjetik mbi prona private, pasi këto çështje trajtohen nga autoritete të tjera kompetente. Për rrjedhojë, ERE nuk mund të vlerësojë ligjshmërinë e shtrirjes së objektit mbi një pasuri private, aq më tepër kur nuk është provuar se kontrata koncesionare apo lejet dhe autorizimet mbi bazën e të cilave është licencuar shoqëria janë ndryshuar apo shfuqizuar.

- Pretendimet për cenimin e pronës private lidhen me të drejtën e pronësisë dhe duhet të trajtohen në rrugë civile, sipas nenit 296 të Kodit Civil, nga gjykatat kompetente dhe jo nëpërmjet një procedure administrative pranë ERE-s.

- Në mungesë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë apo të akteve të organeve kompetente që provojnë paligjshmërinë e përdorimit të pronës, kërkesa për pezullimin e licencës vlerësohet të refuzohet, pasi nuk provohet cenimi i kushteve të licencës dhe pretendimet e ngritura nuk hyjnë në kompetencën rregullatore të ERE-s.

- Në lidhje me kërkesën për marrjen e masave mbi plotësimin e kushteve të licencës, sqarojmë se çështjet e së drejtës së përdorimit të pronës nuk përbëjnë kushte licence për prodhimin e energjisë elektrike dhe janë jashtë juridiksionit të ERE-s. Shoqëria rezulton e licencuar pa kushte dhe detyrimi për ruajtjen e së drejtës së përdorimit të territorit lidhet me marrëdhëniet e saj me organet dhe institucionet e tjera kompetente.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të refuzojë kërkesën e paraqitur nga Z.A.V., përfaqësuar nga studio ligjore “B&K Legal & Tax Consulting” sh.p.k., për pezullimin e licencës së shoqërisë “Vokopola Energji” sh.p.k. për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë kërkuuesin dhe shoqërinë “Vokopola Energji” sh.p.k., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti